

V E N D I M

Nr.730, datë 19.11.1998

PËR MIRATIMIN E RITJES SË KUOTËS TË ANËTARËSIMIT NË FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të ligjit nr.7515, datë 1.10.1991 “Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim, në Korporatën Financiare Ndërkombëtare, në Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, në Agjencinë e garantimit të investimeve shumëpalëshe dhe në Qendrën ndërkombëtare për zgjidhjen e konflikteve në investimet”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të miratojë rritjen e kuotës së anëtarësimit të Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar nga 35 300 000 (tridhjetë e pesë milionë e treqind mijë) SDR në 48 700 000 (dyzet e tetë milionë e shtatëqind mijë) SDR.

2. Shtesa e kuotës prej 13 400 000 (trembëdhjetë milionë e katërqind mijë) SDR, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të mbulohet nga kredia e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe nuk do të jetë element i shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit.

3. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për shtesën e kuotës së anëtarësimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Ngarkohet Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko